

VENDIM
Nr. 378, datë 28.12.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E “RREGULLORES PËR LËSHIMIN, TRANSFERIMIN, TËRHEQJEN DHE ANULIMIN E GARANCIVE TË ORIGINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E RINOVUESHME”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 22, pika 1, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; të neneve 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2330/3 prot., datë 26.12.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”,

konstatoi se:

- Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, është hartuar në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Ky ligj është shfuqizuar me ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i botuar në Fletoren Zyrtare nr. 64, datë 14.4.2023, dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas këtij botimi.

- Në nenin 22, pika 2 e këtij ligji përcaktohet se: “ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.”.

- Po ashtu, në nenin 22, pika 14 e këtij ligji është parashikuar se: “ERE duhet t'i bashkohet sistemit rajonal të komunitetit të energjisë për të mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë.”.

- Ky detyrim është përmbushur nga ERE me nënshkrimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

- Në nenin 22, pika 1, të këtij ligji përcaktohet, ndër të tjera, se: “ERE miraton rregullat për lëshimin e garancive të origjinës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të garancive të origjinës.”.

- Në zbatim të këtij përcaktimi është draftuar “Rregullorja për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

- Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, specifikat e sistemit rajonal të garancive të origjinës dhe elementet e regjistrit elektronik të GO-ve.

- Rregullorja përbëhet nga 26 nene, të cilat përcaktojnë kryesisht kërkesat dhe procedurat e ndjekura për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, në përputhje me regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancive të origjinës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

2. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti